

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-84/11

Prishtinë  
26 gusht 2011

Në çështjen ligjore të

**Ž.B.**

*Paraqitësja e kërkesës/Ankuesja*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, kryetare e kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/98/2010, (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA28015, KPA28016, KPA28017, KPA28018, KPA28019 dhe KPA28020), të datës 7 dhjetor 2010, pas seancës së mbajtur me 26 gusht 2011, mori këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ž.B..
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPPK/D/A/98/2010, i datës 7 dhjetor 2010, për sa i përket lëndëve të regjistruara me numrat KPA28015, KPA28016, KPA28017, KPA28018,

**KPA28019 dhe KPA28020.**

- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 330 (treqind e tridhjetë) euro në Buxhetin e Kosovës, brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 23 shkurt 2007 Ž.B., duke vepruar si anëtare e familjes së ngushtë në emër të vjehrrit të saj të ndjerë, ka parashtruar gjashtë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte që ajo të njihet si pronare e disa ngastrave të ndryshme të fituara me anë të trashëgimisë dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ajo ka shpjeguar se këto ngastra kanë qenë të vjehrrit të saj të ndjerë, S.B. . Ajo ka thënë se prona ishte uzurpuar pas përndjekjes së familjes në mesin e qershorit të vitit 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKM dokumentet në vijim:

- Certifikatën e martesës të datës 26 gusht 1977, që tregon se aji ishte martuar me 20 qershor 1960 me R.B., të birin e S.B..
- Fletën poseduese nr. 64 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Istogut, Komuna Kadastrale Banja e Kernines, me 8 gusht 1975.

Fleta poseduese nr. 64 tregon se S.B. ishte pronar ngastrave të kërkuara si në vijim:

Numri i ankesës dhe dosja e AKP-së	Shënim lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-84/11 (KPA28015)	Ngastra nr. 139, në vendin e quajtur “Bresje”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa ndërtesë, arë e klasës së 7-të me sipërfaqe prej 55 ari e 35 m <sup>2</sup> .
GSK-KPA-A-85/11 (KPA28016)	Ngastra nr. 141, në vendin e quajtur “Bresje”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa ndërtesë, arë e klasës së 7-të me sipërfaqe prej 32 ari e 65 m <sup>2</sup> .
GSK-KPA-A-86/11 (KPA28017)	Ngastra nr. 231, në vendin e quajtur “Bresje”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa ndërtesë, arë e klasës së 3-të me sipërfaqe prej 1 ari e 85 m <sup>2</sup> .
GSK-KPA-A-87/11 (KPA28018)	Ngastra nr. 361/1, në vendin e quajtur “Nikolin Grob”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa

	ndërtesë, arë e klasës së 5-të me sipërfaqe prej 95 ari e 93 m <sup>2</sup> .
GSK-KPA-A-88/11 (KPA28019)	Ngastra nr. 361/2, në vendin e quajtur “Nikolin Grob”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa ndërtesë, arë e klasës së 6-të me sipërfaqe prej 73 ari e 88 m <sup>2</sup> .
GSK-KPA-A-89/11 (KPA28020)	Ngastra nr. 362, në vendin e quajtur “Nikolin Grob”, Banja e Kernines, Istog, komerciale pa ndërtesë, arë e klasës së 3-të me sipërfaqe prej 1 ha, 87 ari e 30 m <sup>2</sup> .

Më vonë, gjatë zhvillimit të procedurës paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar edhe një certifikatë të vdekjes të lëshuar nga Republika Socialiste e Serbisë për Komunën e Istogut me 23 nëntor 2007 e cila tregon se N.B., gruaja e S.B., kishte vdekur me 2 janar 1998.

Me 17 tetor 2007 (KPA28015-KPA28019) dhe me 29 shkurt 2008 (KPA28020), ekipi për lajmërim i AKP-së ka dalë tek vendet ku supozohet se gjenden ngastrat që kërkohen dhe kanë vendosur shenjat që tregojnë se prona është lëndë e një kërkesë dhe palët e interesuara duhej ta kishin dorëzuar përgjigjen e tyre brenda 30 ditësh. E tërë prona ishte gjetur e pa uzurpuar.

Fleta poseduese nr. 64 si dhe certifikata e martesës së paraqitëses së kërkesës kanë mundur të verifikohen.

AKP-ja kishte kërkuar nga paraqitësja e kërkesës nëse ajo mund ta paraqiste autorizimin nga trashëgimtarët e mundshëm dhe dokumentet për të dëshmuar lidhjet e saj familjare me S.B.. AKP-ja gjithashtu kishte dashur të dijë nëse ishte iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së S.B.. Paraqitësja e kërkesës u pajtua që të paraqet autorizimet dhe certifikatat që dëshmojnë identitetin e saj por ajo dy herë nuk ju përmbajt afatit të dhënë prej 30 ditësh. Me vonë gjatë procedurës, e bija e paraqitëses së kërkesës ka shpjeguar se nuk ekzistonte ndonjë certifikatë e vdekjes për S.B. sepse vjehrra e paraqitëses së kërkesës kishte vdekur në vitin 1999 (pasi që vdekja nuk ishte regjistruar, ajo ka shpjeguar se nuk kishte ndonjë certifikatë të vdekjes) dhe se kunati i paraqitëses së kërkesës, M.B., i cili kishte jetuar në Slloveni nuk do t’ia jepte autorizimin e nevojshëm paraqitëses së kërkesës.

Me 7 dhjetor 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendim e vet KKPK/A/98/2010 ka hedhur poshtë kërkesat. Sipas nr. 24 të këtij vendimi, Komisioni ka deklaruar se pasi që paraqitësja e kërkesës nuk e kishte dorëzuar certifikatën e vdekjes të vjehrrit të saj, vdekja e tij nuk ishte vërtetuar. KKPK-ja ka gjetur se paraqitësja e kërkesës

nuk ka në lidhje të ngushta familjare me asnjërin nga bartësit të së drejtës pronësore. Duke qenë se paraqitësja e kërkesës nuk kishte mundur të parashtroj autorizimin e asnjërit nga bartësit e së drejtës pronësore përveç certifikatës së vdekjes për vjehrrën e saj dhe kishte deklaruar se kunati i saj kishte refuzuar t'ia jepte asaj autorizimin, KKPK-ja deklaroi se paraqitësja e kërkesës nuk kishte vërtetuar mundësinë e saj për të paraqitur kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore (neni 5.2 i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079).

Vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 11 maj 2011. Me 7 qershor 2011, paraqitësja e kërkesës (më tutje në tekst: “ankuesja”) ka paraqitur gjashtë ankesa identike në Gjykatën Supreme, ku secila nga to përmbante nga një kërkesë të ndryshme.

Ankesat janë përgatitur ekzaktësisht njesoj sikur edhe ankesat në lëndët paralele që janë objekt shqyrtimi në lëndën GSK-A-52/11. Në këto raste, Lista Poseduese Nr. 80 tregon se parcelat kanë qenë në pronësi të vjehrrës (tani e ndjerë) dhe të kunatit të ankueses. Në lëndët e saja të shqyrtimit, sidoqoftë parcelat nuk janë specifikuar në Listën Poseduese Nr. 80, por, sikur që u tha edhe më sipër në Fletën Poseduese Nr. 64. Ankuesja (ose këshilltari ligjor i saj), sidoqoftë, me sa duket nuk kanë vërejtur dallimin dhe arsyetimi i saj ishte i njejtë sikurse edhe në lëndët paralele. Ankuesja ka dhënë këto argumente:

Ankuesja kërkonte që Gjykata Supreme t'ia njeh bijës së saj, L.J. të drejtën e ri-posedimit të pronës se regjistruar si pronë e N.B. (vjehrra e ankueses) e që gjendet në komunën Kadastrale të Belicës.

Ankuesja ka shpjeguar se vjehrrë i saj, S.B., kishte vdekur me 30 maj 1964. Ankuesja me tej ka shpjeguar se burri i saj, R.B., kishte vdekur me 17 janar 1996 në Veliko Gradiste, kurse vjehrra e saj kishte vdekur me 2 janar 1998 në Istog.

Ankuesja iu është referuar dokumenteve të ndryshme të paraqitura në rastet paralele. Gjykata e kam marrë parasysh këtë provë, ndonëse ajo është dashur të paraqitet edhe në këtë rast. Këto dokumente janë:

- Certifikata e vdekjes e lëshuar me 4 maj 2011 nga Republika e Serbisë, Komuna e Istogut, që konfirmon se S.B. kishte vdekur me 30 maj 1964, në ora 12.00, në Belicë,

- Certifikata e vdekjes e lëshuar me 24 janar 1996 nga Republika Federative e Jugosllavisë, Komuna e Velika Graditstes, qe konfirmon se R.B. kishte vdekur me 17 janar 1996 dhe
- Certifikata e vdekjes e lëshuar me 23 nëntor 2007 nga Republika e Serbisë, Komuna e Istogut, që konfirmon se N.B. kishte vdekur me 2 janar 1998.

Në ankesën e saj, ankuesja më tej ka deklaruar se ajo tani do të dorëzonte kërkesën jo në emrin e saj apo të vjehrrit, por në emër të bijës së saj, L.J., e lindur B., e cila supozohet se ishte trashëgimtare ligjore e gjyshes së saj N.B.. Ankuesja ka deklaruar, pa dhënë shpjegime tjera, se bija e saj nuk ka mundur të parashtroj kërkesën vetë në kohën kur kërkesa është dashur të parashtrohet.

Në lëndën paralele GSK-A-52/11, ankuesja ia ka paraqitur gjykatës certifikatën e martesë së bijës së saj si dhe një autorizim me anë të së cilit L.J. e autorizonte ankuesen që t'i paraqes kërkesat në emër të saj lidhur me tetë kërkesat të cilat kanë qenë subjekt i këtij vendimi. Numrat e këtyre rasteve (KPA27996, KPA27999, KPA28001, KPA28009, KPA28010, KPA28012, KPA28013, KPA28014) janë përmendur qartazi. Në ankesën e saj për rastet të cilat do të vendosën këtu, ankuesja iu është referuar këtyre dokumenteve.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

**Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Rasti nuk është nën juridiksionin e KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhëresën për ri-posedim të pronës nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm se dëshmon pronësinë e një pronë të paluajtshme private por edhe kur ai ose ajo aktualisht nuk ka mundësi t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti

me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, në këtë rast paraqitësja e kërkesës nuk ka dëshmuar që ajo ose bija e saj kanë qenë të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së kërkuar pronësore për shkak të konfliktit të vitit 1998/1999. Duke marrë parasysh arsyetimin e ankueses në ankesën e saj dhe referimin që bën në rastet paralele, gjykata vendosi në bazë të të gjitha fakteve të paraqitura në kërkesat e ankueses. Faktet e paraqitura me të vërtetë tregojnë se shkak për humbjen e pronës së supozuar nga paraqitësja e kërkesës është një kontest që ka të bëjë me trashëgiminë e vjehrrit të paraqitëses së kërkesës, S.B..

S.B. kishte vdekur në vitin 1964. Tetë ngastrat e kërkuara nuk janë gjetur të regjistruara në emrin e gruas së tij, vjehrrës së paraqitëses së kërkesës, e as në emër të dy fëmijëve të tij, përfshirë edhe burrin e ndjerë të paraqitëses së kërkesës, por vetëm në emër të vjehrrës së paraqitëses së kërkesës dhe kunatit të saj. Rrjedhimisht, humbja e ngastrave nga burri i paraqitëses së kërkesës dhe vetë asaj nuk rrjedh nga konflikti i armatosur në Kosovë, por nga fakti se burri i paraqitëses së kërkesës nuk ishte përfillur gjatë ndarjes të ngastrave në fjalë pas vdekjes së vjehrrit të saj.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim se kontesti ka po ashtu të bëjë me gjashtë ngastrat e kërkuara në këtë rast. Ky përfundim mbështet me faktin se kunati i paraqitëses së kërkesës ka refuzuar t'ia jap asaj autorizimin. Kjo tregon se familja nuk pajtohet me rrjedhën e veprimit lidhur me ngastrat e kërkuara dhe lë të kuptoj një kontest të supozuar të trashëgimisë. Së fundi, fakti që ngastrat e kërkuara nuk janë gjetur të uzurpuara tregon se humbja e supozuar e pronës nuk është rezultat i konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999.

Arsyetimi i njëjtë vlen edhe për bijën e paraqitëses së kërkesës dhe trashëgiminë e pronës së supozuar të N.B. nga ajo (gjyshja e saj dhe vjehrra e paraqitëses së kërkesës). Nga faktet e paraqitura duhet të përfundohet se shkak që ajo supozohet se nuk mund të ushtroj të drejtën e pronësisë që kërkon nuk është konflikti i armatosur në Kosovë por një kontest i trashëguar brenda familjes.

Sidoqoftë, KKPK-ja nuk duhet të vendos lidhur më këto konteste të trashëgimisë.

Pasi që kërkesa nuk bie në kompetencën e KKPK-së, gjykata nuk duhet të vendos se a mund ndryshimi fundamental në kërkesë (këtu: këmbimi i së drejtës së supozuar pronësore si dhe këmbimi i bartësit të supozuar të së drejtës pronësore) të ketë efekt të vlefshëm në rastet kur ky ndryshim bëhet (a) pas afatit për parashtrimin e kërkesave i caktuar sipas nenit 8 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe (b) vetëm në rastin e dytë të procedurës.

Po ashtu nuk ka ndonjë ndikim fakti se autorizim nga bija e ankueses nuk i referohet gjashtë rasteve që janë subjekt i kësaj ankese por vetëm tetë rasteve të procedurave paralele.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë mundë të vlerësohej me arsye të jetë € 50.000: € 300 (50 + 0,5% e 50.000).

Këto taksa gjyqësore i bart paraqitësi i ankesës në cilësinë e palës gjyqësore. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë me pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë. Neni 47.3 parashihet se nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të caktuar, pala obligohet që të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk paguan taksën brenda afatit të caktuar, pagesa bëhet anë të detyrimit.

**Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it**